

VENDIM
Nr.141, datë 7.12.2011

**PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin planit të investimeve të “Hec Lanabregas” sh.a., për vitin 2012,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., për planin e investimeve për vitin 2012 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e “Hec Lanabregas” sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2012.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Lanabregas” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani